



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 98/2013
Prishtinë, më 19.3.2013, në orën 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N–225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Dukagjin Shala dhe Fazile Bekteshi, MZHE; Ukë Gashi, ZPRK; Haxhi Gashi, USAID/Deloitte; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja, INDEP.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.3.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-158, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-189, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve;
5. Themelimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse të importit;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.3.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 13.3.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-158, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale

Kryetari -Tha se pas shqyrtimit edhe nga ana e Komisioneve të përhershme të Raportit me amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-158, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, nuk ka pas rekomandime apo vërejtje. Por, tha se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka sjellë një shkresë, ku propozon që të fshihen dy nene të Projektligjit: neni 14, paragrafi 1.1 dhe neni 31, paragrafi 2, që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e mineraleve energjetike në shkallë të ultë, për nevoja të amvisërisë dhe zejtarë. Pra, propozimi i tyre, është që të mbesin ashtu siç është në Ligjin bazik.

Visar Ymeri -Tha, nëse fshihen këto dy nene, atëherë mbetet siç ka qenë e rregulluar kjo çështje deri me tani, ndërsa, që ne kemi pas propozim nga KPMM-ja që të bëhet ky ndryshim. Dhe, nëse pranohet propozimi i ministrisë, shtrohet pyetja se si do të bëhet tani e tutje.

Myzejene Selmani -Tha se duhet të përkrahen propozimet e Qeverisë sepse ata kanë për ta zbatuar ligjin dhe duhet të veprohet ashtu.

Shaip Muja - Ndër të tjera, tha se edhe pse i inkadruar vonë në këtë proces, propozoj që të mbetën propozimet e Komisionit sikurse në Projektligj dhe mos të pranohen këto propozime të ministrisë, sepse duhet të merret parasysh se kemi një gjendje sociale shumë të rëndë dhe duhet ti lejojmë qytetaret që t'i shfrytëzojnë ato minerale që i kanë në pronat e veta, për nevoja të tyre familjare. Ndërsa, është çështje e KPMM-së se si do t'i monitorojë këto aktivitete.

Sala Berisha – Shala - Tha se propozimi i ministrisë është shumë i vonuar dhe është dashtë të na bind me herët, e jo tani në këtë fazë. Ajo tha se ne duhet të vendosim se cilën anë apo propozim ta marrim parasysh, atë të KPMM-së apo atë të Qeverisë dhe ne si deputet mund të vendosim sot dhe kjo çështje të shkojë tutje dhe të miratohet ligji.

Pas debatit më 4 (katër) vota për, 4 (katër) vota kundër dhe 1 (një) abstenim, Komisioni nuk e përkrahu propozimin e ministrisë që të fshihen të dy nenet, ai 14, paragrafi. 1.1 dhe neni 31, paragrafi 2.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-158, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale;*
- 2. Raporti t'i procedohet seancës plenare sipas procedurës.*

4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-189, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari - Pas shqyrtimit nga ana e Komisioneve të përhershme të Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-189, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, nuk ka pas ndonjë rekomandim apo vërejtje dhe mund ta procedojmë për seancë plenare për miratim.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-189, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve;*
2. *Raporti t'i procedohet seancës plenare, sipas procedurës.*

5. Themelimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për masat mbrojtëse të importet

Kryetari - Tha që për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse të importet, është paraparë dhe në planin e punës së Komisionit për vitin 2013 dhe të formohet një grup i punës dhe të mbikëqyrjet zbatimi i këtij ligji.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, për masat mbrojtëse në importe;*
2. *Grupi punues ka këtë përbërje: Zenun Pajaziti, raportues, Teuta Sahatqija, Shaip Muja Lutfi Zharku dhe Visar Ymeri, anëtarë;*
3. *Secili anëtarë i Komisioni, sipas interesimit mund t'i bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij;*
4. *Grupi punues, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

6. Të ndryshme Çështje vijuese

Kryetari - Propozoj një vizitë pune në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, me qëllim që të njoftohemi për së afërmi si Komision parlamentar, me punën dhe sfidat e ZRRE-së.

Pas debatit Komisioni vendosi që të vizitohet Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE-ja) më datë 21.3.2013, në orën 10:00

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit